



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 179 / Prot.

Datë 03 / 02 / 2026

UDHËZUES

Në funksion të objektit të punës së Këshillit të Etikës në Universitetin e Tiranës (KE-UT) dhe në përmbushje të funksioneve të përcaktuara në Ligjin nr. 85/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 44; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 43, pika 2; Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës, neni 3 dhe neni 9, si dhe në zbatim të shkresës Nr. 3277/1 Prot., datë 30/10/2025 me lëndë “Mbi miratimin paraprak të instrumenteve që përdoren në kërkimet shkencore”, me qëllim lehtësimin e komunikimit me njësitë përbërëse të UT-së dhe unifikimin e aspekteve procedurale për miratimin nga ana e KE-UT të elementeve etikë në projektet kërkimore dhe instrumentet e kërkimit të zhvilluara nga UT dhe nga partnerët e saj, Këshilli i Etikës i Universitetit të Tiranës ka hartuar dhe miratuar një paketë udhëzuese mbi praktikën e aplikimit dhe miratimit etik të instrumenteve të kërkimit dhe projekteve kërkimore.

Paketa udhëzuese përmban:

1. Dokumentet që duhet të dorëzohen bashkëlidhur kërkesës për miratimin e elementëve etikë

Kërkesa (*Aneksi 1*) për miratim të elementëve etikë të kërkimit paraqitet në respektim të hierarkisë së brendshme institucionale, si më poshtë:

- *Në rastin e kërkesave nga doktorantët:*
Kërkesa paraqitet e firmosur nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor dhe i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit e përcjell kërkesën pranë Dekanit, i cili ia drejton Rektorit të UT-së.
- *Në rastin e projekteve kërkimore dhe iniciativave të tjera kërkimore:*
Kërkesa paraqitet nga koordinatori/drejtuuesi i grupit të projektit ose studiuesi pranë departamentit përkatës, i cili e përcjell tek Dekani, dhe më pas Dekani ia përcjell Rektorit. Në rastet e projekteve ndërdepartamentale kërkesa depozitohet drejtpërdrejt tek Dekani, i cili bën përcjelljen drejt Rektorit.

Dokumentet shoqëruese të kërkesës¹

i. Përshkrimi i projektit kërkimor (Aneks 2)

Përshkrimi i projektit duhet të përfshijë:

- Studiuesin / grupin e punës;
- Titullin e studimit / projektit kuadër;
- Qëllimin / qëllimet e studimit;
- Pyetjet kërkimore dhe/ose hipotezat;
- Metodologjinë e studimit, duke përfshirë:
 - popullatën dhe kampionin;
 - procedurat e grumbullimit të të dhënave;
 - metodat e analizimit të të dhënave;
- Përshkrimin e instrumenteve që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave;
- Aspektet etike dhe mbrojtjen e të dhënave, përfshirë:
 - planin e ruajtjes dhe sigurimit të të dhënave;
 - vlerësimin e rreziqeve dhe masat për mbrojtjen e pjesëmarrësve;
- Kalendarin e aktivitetit kërkimor.

ii. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave duhet të paraqiten në formën përfundimtare, gati për implementim. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave të hartuar në gjuhë tjetër duhet të jenë patjetër edhe në gjuhën shqipe. Në rastin e doktorantëve, instrumentat duhet të jenë të miratuar me shkresë nga udhëheqësi shkencor dhe/ose i firmosur faqe për faqe nga udhëheqësi dhe doktoranti.

Në këtë seksion përfshihen të gjitha instrumentet që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave, si:

- pyetësorë të strukturuar;
- udhëzues interviste;
- udhëzues fokus-grupi;
- eksperimente;
- instrumente të tjera kërkimore.

Kujdes:

Në rastin e pyetësorëve të strukturuar për mbledhjen e të dhënave sasiore (ballë për ballë ose online), instrumenti në krye të tij duhet të shoqërohet detyrimisht me një informacion të plotë për pjesëmarrësin, ku të specifikohet:

- përshkrimi i studimit/projektit;
- subjekti që e realizon studimin dhe kuadri institucional;
- kohëzgjatja e plotësimit të pyetësorit;
- mënyra e përdorimit të të dhënave;
- e drejta për t'u tërhequr në çdo moment;

¹ Shënim: Dokumentacioni i kërkuar në këtë paketë si shoqërues i kërkesës është i detyrueshëm, por në rast se protokollet e kërkimit parashikojnë edhe kritere ose kërkesa të paparashikuara në këtë paketë, studiuesi ftohet t'i paraqesë ato në një aneks shtesë të dokumentacionit bashkëshoqërues të kërkesës.

- pyetja konfirmuese për dhënien ose jo të pëlqimit për vijimin e plotësimit të pyetësorit.

iii. Formulari i pëlqimit të informuar (Aneksi 3)

Formulari i pëlqimit të informuar duhet të përmbajë minimalisht:

- qëllimin e studimit;
- çfarë pritet nga pjesëmarrësi në studim;
- kohëzgjatjen e pjesëmarrjes;
- deklaratën mbi konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave;
- të drejtën e pjesëmarrësit për t'u tërhequr në çdo moment;
- qëllimin e përdorimit të të dhënave;
- garantimin e anonimatit;
- mënyrën e mbrojtjes së të dhënave;
- kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave dhe mënyrën e asgjësimit të tyre.

2. Formulari i vlerësimit të elementëve etikë nga KE-UT (Aneksi 4)

Vlerësimi i elementeve etikë nga Këshilli i Etikës i Universitetit të Tiranës (KE-UT) ka për objekt verifikimin e respektimit të parimeve themelore të etikës së kërkimit shkencor, konkretisht: respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut, garantimin e mirëqenies dhe sigurisë së pjesëmarrësve, parimin e drejtësisë, si dhe ndershmërinë, integritetin dhe praktikën e mirë shkencore. KE-UT shqyrton në mënyrë të posaçme përmbushjen e detyrimit për informimin e plotë dhe të kuptueshëm të pjesëmarrësve, marrjen e pëlqimit të informuar, mbrojtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit, përpunimin, ruajtjen dhe kufizimet në ripërdorimin e të dhënave personale të identifikueshme, shmangien e çdo forme dëmi, mashtrimi ose manipulimi të pajustificuar, respektimin e grupeve vulnerabël, si dhe marrjen parasysh të ndikimit të kërkimit shkencor mbi palët e treta. *Përfundimi i vlerësimit etik përbën bazë procedurale për marrjen e vendimit përfundimtar të KE-UT mbi miratimin etik, miratimin me kushte ose mosmiratimin e projekt-aplikimit.*

KE sjell në vëmendje se zbatimi i projektit kërkimor duhet të realizohet në përputhje të plotë me parimet themelore të etikës së kërkimit shkencor, duke garantuar pjesëmarrjen vullnetare dhe të lirë të subjekteve të përfshira, marrjen paraprake të pëlqimit të informuar, ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimatit të të dhënave, si dhe shmangien e çdo forme dëmi fizik, psikologjik, emocional apo social. Gjatë zhvillimit të kërkimit kërkohet përdorimi i gjuhës neutrale dhe të paanshme, respektimi i normave kulturore dhe i të drejtave të njeriut, si dhe siguri që kërkimi të ketë qëllim shkencor të ligjshëm dhe vlerë kontribuese për komunitetin akademik dhe shoqërinë.

Miratimi nga KE do të thotë që kërkimi të zhvillohet strikt sipas projektit të miratuar. Çdo ndryshim në objekt, metodologji, instrumente, popullatë studimi ose aspekte të tjera me ndikim

etik i nënshtrohet detyrimit rishqyrtimit dhe miratimit paraprak nga Këshilli i Etikës i Universitetit të Tiranës.

Bashkëlidhur anekset e sipërpërmendura.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

The image shows a circular official stamp in blue ink. The outer ring of the stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËS" at the top and "UNIVERSITETI I TIRANËS" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania, which features a double-headed eagle. Overlaid on the right side of the stamp is a handwritten signature in blue ink.

**ANEKSI 1: TEMPLATE KËRKESË PËR MIRATIM TË ELEMENTËVE ETIKË TË
KËRKIMIT NGA KE-UT**

Nr. ____ Prot.

Tiranë, _____.____.202_

Lënda: Kërkesë për miratim të elementëve etikë të kërkimit nga Këshilli i Etikës

Drejtuar: _____

Përmbajtja e rekomanduar:

I/E nderuar _____,

Unë, [Emri Mbiemri], [roli: student/kerkues/staf akademik], pranë [Fakulteti/Departamenti], paraqes pranë jush kërkesën për miratimin etik të pyetsorit/projektit të kërkimit me të dhënat si më poshtë:

Titulli i studimit/projektit: _____

Udhëheqësi shkencor (te doktorantët): _____

Studiuesi kryesor / Grupi kërkimor: _____

Statusi i kërkimit:

☐ Punim doktrature

☐ Projekt kërkimor

☐ Iniciativë tjetër kërkimore (specifiko) _____

Kohëzgjatja e parashikuar e studimit: Nga ____ / ____ / ____ deri më ____ / ____ / ____

Në përmbushje të kriterëve dhe kërkesave nga KE -UT bashkëlidhur kësaj kërkesë dokumentacioni si më poshtë vijon:

i. Përshkrimi i projektit kërkimor

ii. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

iii. Formulari i pëlqimit të informuar

Dokumentacioni i përcjellë është hartuar dhe përcjellë sipas anekseve respektive të KE-UT.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Me respekt,

Me respekt,

Emri dhe mbiemri: _____

Funksioni / Statusi: _____

Nënshkrimi: _____

(Te doktorantët)

Udhëheqësi shkencor: _____

Nënshkrimi: _____

Kontakti: _____

ANEKSI 2: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT KËRKIMOR

Këshilli i Etikës
Universiteti i Tiranës

Rregjistrim i aplikimit

Drejtuar: Këshillit të Etikës
Universiteti i Tiranës

DATA

TITULLI I
PROJEKTIT
KERKIMOR

APLIKUESI

EMËR MBIEMËR

E-MAIL

POZICIONI

☐

Bashkëpunëtor

☐

Doktorant

☐

Studiues

☐

Institucion/organizatë

☐

Diplomant

FUSHA

☐ Shkenca Ekonomike	☐ Shëndet dhe mirëqënie
☐ Shkenca Sociale	☐ Juridik
☐ Shkenca të Natyrës	☐ Gazetari dhe informim
☐ Shkenca humane	☐ Shkenca të edukimit
☐ TIK	☐ Tjetër (specifiko) _____

STUDIUES PJESËMARRRËS

Vendosni emër, mbiemër dhe pozicionin e personelit që do të përdorë të dhënat. Diplomantët dhe doktorantët duhet të vendosin dhe emnin e bashkëautorit/ udhëheqësit të tezës, duke shënuar “bashkëautor” ose “udhëheqës” në kolonën “SHËNIME”.

NUMRI i GRUPIT KERKIMOR	
-------------------------------	--

[illegible]

FJALE KYÇE

1		2		3	
---	----------------------	---	----------------------	---	----------------------

METODA E KËRKIMIT

☐ Eksperiment laboratorik	☐ Mbledhje të dhënash nëpërmjet vizitash mjeksore
☐ Përpunim i testeve standart/shkallë/pyetësorë	☐ Mbledhje të dhënash nga arkivi
☐ Mbledhje të dhënash nëpërmjet intervistave dhe/ose fokus grupeve	☐ Vëzhgimi
☐ Video-rregjistrim	☐ Tjetër (specifiko) _____

Përcakto tipologjinë dhe emrin e instrumenteve të përdorur

PERSHKRIMI DHE QËLLIMI

- Jepni një përshkrim të shkurtër teorik të projektit (pa bibliografi)
- Përshkrim i objektivave
- Përshkrim i metodologjisë, duke i dhënë rëndësi të veçantë metodave të rekrutimit, përpunimit, marrjes së informacionit dhe miratimit të informuar
 - bëni kujdes të jepni fakte si: vendndodhjen e sondazhit, kohëzgjatja e provës/detyrës/observimit, tipi i detyrës/procedurës eksperimentale
- Rolin e pjesëmarrësve brenda procedurës

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There is no handwriting or other markings on the paper.

KARAKTERISTIKAT E SUBJEKTEVE PJESEMARRES/ PËRSHKRIM I GRUPIT TË PJESEMARRËSVE

INFORMACIONI I DHËNË PJSËMARRËSIT MBI QËLLIMIN

☐ Përpara ndërhyrjes

☐ Gjatë ndërhyrjes

☐ Pas ndërhyrjes

☐ Tjetër
(specifiko) _____

MIRATIMI I INFORMUAR

MIRATIMI: ☐ Verbal ☐ Shkruar ☐ Verbal dhe Shkruar

KUSH ADMINISTRON MIRATIMIN E INFORMUAR (EMRI DHE/OSE ROLI NË PROJEKT)

KUJT I MERRET MIRATIMI I INFORMUAR

- ☐ Subjektit pjesëmarrës ☐ Prindi (në rastin e minorenëve)
- ☐ Përgjegjësi i Institucionit ku janë marrë të dhënat
- ☐ Tjetër (specifiko) _____

SI JANË MBLEDHUR TË DHËNAT

- ☐ Të dhëna të mbledhura në mënyrë anonime (të dhënat personale të pjesëmarrësve **NUK rregjistrohen***)
- ☐ Të dhëna të mbledhura në mënyrë konfindenciale (të dhënat personale të pjesëmarrësve **rregjistrohen** por garantoen që nuk do ti jepen të tretëve)
- ☐ Tjetër (specifiko) _____

* Kujdes: nëse të dhënat janë mbledhur në mënyrë anonime, **në asnjë fazë të studimit** nuk mund të kërkoen informacione që cojnë në identitetin e pjesëmarrësit që i është përgjigjur pyetësorit, që ka marrë pjesë në test ose provën e zhvilluar.

KALENDARI I STUDIMIT:

RISQET PER PJESEMARRESIT

☐

Asnjë risk

☐

Dhimbje fizike

☐

Përdorim i agjentëve fizike/ kimike

☐

Ndërhyrja e mjeteve

☐

Lodhje

☐

Stres ose tension emocional

☐

Induktim i mundshëm i ndjenjave negative (p.sh. shqetësim, nënvleftësim, stres i shtuar, stigmatizim, ankth deri depresio)

☐

Tjetër

Në rast të rrisqeve të çdo lloji, specifikoni natyrën dhe intensitetin e tyre, justifikoni kërkimin në dritën e dëmeve/përfitimeve, specifikoni masat paraprake për të kufizuar dëmin dhe llojin e mbështetjes për pjesëmarrësin.

Specifikoni se si synoni të siguroheni që testet e administruara ose pyetjet e bëra në intervistë ose pyetësor të mos kenë efekte negative në gjendjen emocionale të pjesëmarrësve ose të lëndojnë ndjeshmërinë e tyre.

PËRFITIMI

Çfarë përfitohet ?

Kush është përfituesi ?

INFORMACIONE OSE VËZHGIME TË TJERA ME RËNDËSI ETIKE PËR PROJEKTIN KËRKIMOR (në rast se ka)

Personi përgjegjës (drejtuesi) për projektin kërkimor deklaron se njih Kodin e Etikës të UT-së. Drejtuesi për projektin kërkimor garanton gjithashtu, nën përgjegjësinë e tij, se studimi i kryer është në përputhje me këtë Kod Etike.

Firma

ANEKSI 3: FORMULARI I PËLQIMIT TË INFORMUAR

Nëse miratimi i informuar është me shkrim, më poshtë një material ndihmues, ndiqni udhëzimet e dhëna në formatin e mëposhtëm, të dalluara me ngjyrën gri. Jeni të lutur të të zëvendësoni pjesën me ngjyrë gri me informacionin e duhur për studimin tuaj. Gjithashtu fshini pjesët që nuk përputhen me studimin tuaj. Teksti final i hedhur në formatin e mëposhtëm duhet të përmbajë vetëm tekstin e miratimit të informuar që parashikohet t'ju jepet pjesëmarrësve.

FORMULARI I PËLQIMIT TË INFORMUAR

Titulli i projektit të kërimit _____

Drejtuesi shkencor _____ (mail: _____ ; tel. _____)

Bashkëautorë dhe bashkëpunëtorë të tjerë në projekt: *vendosni emrin, mbiemrin, mail dhe telefon të personelit pjesëmarrës*

Përpara se të vendosni me vullnet të plotë që do merrni pjesë në projektin kërkimor në fjalë, **LEXONI ME KUJDES** këtë miratim të informuar. Të gjitha pyetjet dhe paqartësitë që keni mbi qëllimin dhe mënyrat e zbatimit të këtij projekti mund t'ia paraqisni drejtuesit shkencor ose njërit prej bashkëpunëtorëve (vendosni emer, mbiemer, mail dhe telefon). Ju kujtojmë që pjesëmarrja juaj është me vullnet të lirë.

QËLLIMI I STUDIMIT

Përshkruaj një përmbledhje

PROCEDURAT E STUDIMIT

I propozojmë çdo pjesëmarrësi në studim që të njihet me: (Listoni dhe përshkruani në mënyrë të përmbledhur të gjithë instrumentet që do të perdoren, psh. Testet që do përfshihen...puna dhe funksionet ekzekutive; pyetësorët) Përdorni një gjuhë të kuptueshme edhe për ata që nuk janë profesionistë dhe jepni disa shembuj të pyetjeve që do bëhen ose detyrave që do t'iu ngarkohen.

Administrimi i testit do të audiorregjistrohet ose videoregjistrohet

TRAJTIMI I TE DHENAVE

Nëse të dhënat janë mbledhur në mënyrë anonime, specifikoni nëse të dhënat e publikuara do ti perkasin kampionit të kërimit dhe tregoni në c'mënyrë do të bëhen publike (psh. Temë diplome, temë doktorature, artikuj shkencorë, kongrese etj.)

RISQET, DEMTIME DHE EFEKTET ANESORE

(jeni të lutur të hiqni pjesët që nuk i perkasin studimit tuaj)

Nëse nuk ka: Pjesëmarrja në studim nuk përmban rreziqe ose dëmtime fizike dhe/ose emocionale për shëndetin.

Nëse ka : përshkruaji

Ju kujtojmë se mund të ndërprisni pjesëmarrjen në studim dhe të tërhiqeni NË ÇDO MOMENT pa dhënë arsye e vendimit. Me nënshkrimin e miratimit të informuar në fjalë nuk hiqni dorë nga asnjë e drejtë juaj ligjore.

I gjithë materiali në lidhje me studimin është pronë e _____ dhe administrohet nga _____.

Ju kërkojmë të na autorizoni që të përdorim të dhënat në mënyrë anonime për aktivitetet e mëposhtme:

- ☐ aktivitete kërkimore e botuese duke mbrojtur anonimitetin dhe mosnjohjen e personit
- ☐ aktivitete mësimore dhe trajnuese, duke mbrojtur anonimitetin dhe mosnjohjen e personit

Vendi dhe data

FIRMA.....

Kohët e ruajtjes së të dhënave personale dhe të të dhënave sensitive do të jenë si më poshtë:

1. Të dhënat personale dhe të kontaktit do të ruhen për kohën e nevojshme për përfundimin e kërimit dhe në çdo rast për një periudhë 5-vjeçare nga përfundimi i kërimit;
2. Të dhënat e kërimit do të ruhen për një periudhë minimale prej 5 vitesh.

Nënshkrimi vërteton që:

1. **Ju keni lexuar të gjithë informacionin mbi qëllimin dhe procedurat e projektit kërkimor dhe keni marrë të gjithë informacionet që i përkasin procedurave;**
2. **Ju keni pranuar të merrni pjesë në studimin për të cilin ju kërkohet miratimi i mbrojtjes së të dhënave dhe trajtimi i tyre sipas Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”**

Unë i nënshkruari, pasi lexova pjesën informuese mbi qëllimin dhe procedurat e këtij projekti kërkimor

PRANOJ ☐

NUK PRANOJ ☐

Të marr pjesë në projektin kërkimor

Vendi dhe data.....

EMËR, MBIEMËR, FIRMA.....

.....

KUJDES! Nëse të dhënat janë mbledhur në mënyrë anonime teksti me ngjyrë të kuqe, bold dhe underline, duhet të zëvendësohet si më poshtë:

Pranimi juaj vërteton që:

1. Ju keni lexuar të gjithë informacionin mbi qëllimin dhe procedurat e projektit kërkimor dhe keni marrë të gjithë informacionet që i përkasin procedurave;
2. Ju keni pranuar të merrni pjesë në studimin për të cilin ju kërkohet miratimi i mbrojtjes së të dhënave;

Pasi lexova pjesën informuese mbi qëllimin dhe procedurat e këtij projekti kërkimor deklaroj që

PRANOHET ☐

NUK PRANOHET ☐

Të marr pjesë në projektin kërkimor

ANEKSI 4: FORMULAR I VLERËSIMIT TË ELEMENTËVE ETIKË NGA KE-UT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS KËSHILLI I ETIKËS

Tiranë më ____ / ____ / ____

FORMULAR I VLERËSIMIT TË ELEMENTËVE ETIKË NGA KE-UT

Titulli i Projekt-aplikimit: _____

Personi përgjegjës për projekt-aplikimin: _____

Studiues/Grup studiuesish: _____

Institucioni/organizata/subjekti që do të zbatojë projektin _____

A i ka respektuar aplikimi përmbushjen e kritereve etike për kërkimin shkencor?

Ju lutem shënoni nëse Po/Jo.

- | | | |
|--|----|----|
| • Respekti për individin: | Po | Jo |
| • Mirëqenia: | Po | Jo |
| • Siguria: | Po | Jo |
| • Drejtësia: | Po | Jo |
| • Ndershmëria dhe praktika e mirë shkencore: | Po | Jo |

Përmbushja e kritereve të kodit të etikës së kërkimit shkencor:

- | | | |
|--|----|----|
| 1) Respektimi i të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor | Po | Jo |
| 2) Integriteti i studiuesve dhe pjesëmarrësve individualë | Po | Jo |
| 3) Detyrimi për të mos shkaktuar asnjë dëm | Po | Jo |
| 4) Detyrimi për të informuar pjesëmarrësit | Po | Jo |
| 5) Përdorimi i mashtrimit/manipulimit | Po | Jo |
| 6) Kërkesa e kufizuar për pëlqimin e informuar | Po | Jo |

7) Kërkimi shkencor/hulumtimi pa pëlqimin e informuar	Po	Jo
8) Pjesëmarrja e fëmijëve në kërkim shkencor	Po	Jo
9) Respektimi i të drejtës së privatësisë dhe marrëdhënieve intime	Po	Jo
10) Konfidencialiteti	Po	Jo
11) Marrja parasysh/konsiderimi i ndikimit mbi palët e treta	Po	Jo
12) Përpunimi i të dhënave personale dhe ruajtja e informacionit të identifikueshëm personal	Po	Jo
13) Kufizimet në ripërdorimin e të dhënave personale të identifikueshme	Po	Jo
14) Përgjegjësia e studiuesve për të dhënë përshkrime të qarta të roleve të tyre		
15) Kërkesa për pavarësi nga pjesëmarrësit	Po	Jo
16) Respekt për vlerat, opinionet dhe kulturat e të tjerëve	Po	Jo
17) Respekt për njerëzit që i përkasin grupeve vulnerabël	Po	Jo
18) Respekt për të ndjerin	Po	Jo
19) Respekt për artefaktet kulturore	Po	Jo

Vlerësimi përfundimtar Kalues/Jo kalues (shëno): _____

Rekomandime për përmirësime (shëno)

Komisioni

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.